

VENDIM
Nr. 206, datë 9.9.2025

MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN GUSHT 2025, PËR KLIENTËT E LIDHUR NË NIVELIN E TENSIONIT 35 kV

Në mbështetje të neneve 16 dhe 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” të ndryshuar; të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar me vendimin nr. 144, datë 25.6.2018 dhe nr. 233, datë 20.12.2019; dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.9.2025, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 2396/1 prot., datë 4.9.2025, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin gusht 2025, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV”,

konstatoi se:

I. Aspektet ligjore dhe procedurale

1. Paraqitja e kërkesës nga “FSHU” sh.a.

Shoqëria “FSHU” sh.a., me shkresën nr. 4646 prot., datë 2.9.2025, protokolluar në ERE me nr. 2396 prot., datë 3.9.2025, ka depozituar kërkesën për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për muajin gusht 2025, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.

2. Procesi i shqyrtimit të dokumentacionit nga ERE

Kërkesa është shqyrtuar në përputhje me nenin 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, si dhe në mbështetje të neneve 16 dhe 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe “Metodologjisë për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar.

II. Analiza e përlllogaritjes së çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin gusht 2025, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV

1. Blerja e energjisë në bursë

Për muajin gusht 2025, “FSHU” sh.a. ka siguruar sasinë e nevojshme të energjisë elektrike për këtë kategori klientësh përmes blerjeve mujore në Bursën Shqiptare të Energjisë (ALPEX), duke u bazuar në profilet ditore të prokurara, çmimet ditore/orare dhe vlerat përkatëse të faturuara.

2. Përlllogaritja e çmimit mesatar të ponderuar të blerjes (ÇBEt)

Bazuar në të dhënat e paraqitura, “FSHU” sh.a. ka përlllogaritur çmimin mesatar të ponderuar të blerjes së energjisë elektrike për muajin gusht 2025 në vlerën 10.92 lekë/kwh. Kjo vlerë është verifikuar edhe nga ERE, nëpërmjet një rillogaritjeje, nga e cila rezultoi se mesatarja e ponderuar e çmimit të blerjes së energjisë elektrike është 10.92 lekë/kwh, në përputhje me përlllogaritjet e paraqitura nga shoqëria.

3. Komponentët sipas metodologjisë (neni 8, vendimi nr. 201, datë 4.12.2017, i ndryshuar)

Në përputhje me metodologjinë përkatëse, komponentët e përdorur për përlllogaritjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike janë si më poshtë:

- Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë elektrike (ÇBEt) për muajin gusht 2025: **10.92 lekë/kwh;**

- Tarifa e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 1 shkurt 2025 – 31 dhjetor 2027, e miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 279, datë 16.12.2024: **0.85 lekë/kwh;**

- Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivel tensioni 35 kV, sipas vendimit të Bordit të ERE-s nr. 288, datë 23.12.2024, “Mbi lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 73, datë 13.04.2022”: **1.55 lekë/kwh;**

- Kostot administrative: **1.06 lekë/kwh;**

- Kurset zyrtare të këmbimit të publikuara nga Banka e Shqipërisë (lekë/euro), për çdo datë respektive në harkun kohor **31.7.2025–29.8.2025.**

- Në zbatim të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, referuar aplikimit të “FSHU” sh.a., si dhe mbështetur në llogaritjet e ERE-s, çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin gusht 2025, përlllogaritet si më poshtë:

<i>Çmimi i energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV për muajin gusht 2025</i>		
	<i>Njësia</i>	<i>Çmimi</i>
CBEt Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë elektrike	Lekë/kWh	10.92
Pr Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Lekë/kWh	0.33
CA Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Lekë/kWh	1.06
TRr Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Lekë/kWh	0.85
TSht Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Lekë/kWh	1.55
Çmimi i energjisë =CBEt +Pr* CBEt +TRr +TSht +CA		14.70

- Bazuar në çdo element të formulës llogaritëse, si dhe duke marrë në konsideratë të dhënat e paraqitura në aplikimin e shoqërisë, rezulton se:

- Çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit rezulton **14.70 lekë/kwh për muajin gusht 2025.**

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin gusht 2025, prej **14.70 lekë/kwh** për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.

2. Ndryshimi i secilit element përbërës në llogaritjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për kategoritë e klientëve të cilësuar në këtë vendim, do të përbëjë shkak për rishikimin e këtij vendimi nga Bordi i ERE-s.

3. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti